



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës NR. 06/L-092, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e datës 3 prill 2019 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunes bën këtë:

**FTESË PUBLIKE
PËR DËRGIMIN E PROPOZIMEVE PËR ANËTARË TË KOMISIONIT VLERËSUES
NGA SHOQËRIA CIVILE
(VAZHDIM I AFATIT PËR APLIKIM)**

Ftohen përfaqësuesit e Organizatave Joqeveritare - Shoqërisë civile të cilat veprojnë dhe kanë selinë në territorin e Komunës së Lipjanit, të dërgojnë propozimet e tyre për plotësimin e Komisionin vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës me një anëtar ekspert nga shoqëria civile pasi është vazhduar afati për aplikim.

Propozimet sipas mundësisë duhet të përfshijë personat me prioritet nga lëmi i shkencave juridike, ekonomike, bujqësore apo të ndonjë lëmie tjetër të pregaditjes superiore.

Propozimet tuaja do të jenë të mirëpritura dhe duhet ti drejtohen Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe të njëjtat të dorëzohen në ndërtesën e Komunës kati I në Qendrën për shërbime për qytetarë sporteli nr.2 brenda afatit 15 ditor nga dita e publikimit të kësaj ftese publike.

Numri i anëtarëve të përzgjedhur nga Komuna nuk është i kufizuar pasi edhe nëse kemi dy ose më shumë propozime nga shoqëria civile të njëjtin do të emërohen me rotacion për secilin Vendim paraprak dhe për punën e tyre do të kompensohen në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Ftesa të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr 060-77103/2
Më datë: 12.01.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

